

BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

V E N D I M

Nr. 42 Datë 10 / 03 / 2020

“Për miratimin e investimit “Ndërtimi i linjës së furnizimit me uje të pijshëm Gurra e Epërme-Luzni-Peshkopi””.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, sipas shkresës nr.784 prot. datë 25.02.2020 për ndarjen e fondit për objektin e mësipërm në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.354 datë 11.05.2016 ‘Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim’ bëhet ndarja e fondit për objektin në fjalë, si dhe të shkresës nr.783 prot. datë 25.02.2020 “Dërgohet detajimi i buxhetit të viteve 2020-2022, për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për programin ‘Furnizimi me ujë dhe kanalizime’, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Dibër më datë 10 / 03 / 2020 miratoi me 17 vota pro, kundër — vota, abstenim —:

VENDOSI:

- I. Miratimin e investimit të ardhur për Bashkinë Dibër për objektin “Ndërtimi i linjës së furnizimit me ujë të pijshëm Gurra e Epërme-Luzni-Peshkopi”, me vlerë projekti 254,143,833 (dyqind e pesëdhjetë e katër milion e njëqind e dyzetë e tre mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë, sipas shkresës nr.784 prot. datë 25.02.2020 për ndarjen e fondit për objektin e mësipërm në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.354 datë 11.05.2016 ‘Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim’ bëhet ndarja e fondit për objektin në fjalë, si dhe të shkresës nr.783 prot. datë 25.02.2020 “Dërgohet detajimi i buxhetit të viteve 2020-2022, për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për programin ‘Furnizimi me ujë dhe kanalizime’.

II.

Të shtohet :

Gr.06 Tit. 6370 Kap. 1 Art.231 50.720.670 lekë.

III. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Urbanistikës, Sektori i Prokurimeve dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.

IV. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Inva TRUPJA



KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Sokol SAVA

